



Në mbështetje të nenit 26, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe të nenit 62, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me datë 14.07.2023, miraton:

## **UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 04/2023 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR LIRIM OSE ZVOGËLIM TË GJOBËS**

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Ky Udhëzim Administrativ (në tekstin e mëtejshëm - Udhëzimi), ka për qëllim përcaktimin e procedurës dhe kriterëve sipas të cilave Autoriteti i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm - Autoriteti) do të marrë vendimet për lirim ose zvogëlim të gjobës, ndaj ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të ndaluar - kartel.
2. Qëllimi i lirimit ose zvogëlimit të gjobës, është inkurajimi i ndërmarrjeve pjesëmarrëse në kartel që të zbulojnë ekzistencën e karteleve, t'i japin fund pjesëmarrjes së tyre në kartel dhe të bashkëpunojnë me Autoritetin kur hetohet karteli.

### **Neni 2 Përkufizimet**

1. Në këtë Udhëzim, shprehjet në vijim kanë kuptimet:

1.1. **Gjobë** - nënkupton gjobën e shqiptuar nga Autoriteti ndaj ndërmarrjes për shkelje të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm - LMK), siç është specifikuar në nenin 57, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të LMK.

1.2. **Marrëveshjet e ndaluara (kartelet)** - nënkupton një marrëveshje ose praktikë të bashkërenduar ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, që synojnë të koordinojë sjelljet e tyre konkurruese në treg, ose të ndikojë në parametrat përkatës të konkurrencës me anë të praktikave të tilla, por pa u kufizuar në fiksimin ose koordinimin e çmimeve të blerjes ose shitjes, ose edhe të kushteve tjera tregtare, duke u përfshirë në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale, shpërndarjen e kuotave të prodhimit ose shitjes, ndarjen e tregjeve dhe klientëve, përfshirjen dhe

manipulimin me oferta, kufizimet e importeve dhe eksporteve, ose veprimet anti-konkurruese kundër konkurrentëve të tjerë.

1.3. **Iniciatori** - nënkupton ndërmarrjen e cila ka organizuar dhe drejtuar kryerjen e aktivitetit kartel. Ndërmarrjet të cilat janë angazhuar në bisedime ose kanë bërë thirrje për bashkim në kartel, nuk do të konsiderohen iniciator të kartelit në kuptim të këtij Udhëzimi.

1.4. **Nxitësi** - nënkupton ndërmarrjen e cila në mënyrë aktive inkurajon ndërmarrjet tjera ose konkurrentët e tyre për tu bashkangjitur në kartel, veçanërisht me anë të detyrimit apo kërcënimit, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

1.5. **Kërkesë** - nënkupton kërkesën për lirim ose zvogëlim të gjobës e cila dorëzohet në Autoritet, nga ndërmarrja pjesëmarrëse në kartel, në përputhje me LMK dhe këtë Udhëzim.

1.6. **Shënues** - rezervimi i mundësisë që një ndërmarrje të futet në radhën për përjashtim nga gjoba, pas paraqitjes së kërkesës dhe mbledhjes së informacioneve e provave të mjaftueshme, për të përmbushur kushtet për përjashtim nga gjoba.

1.7. **Deklarata e ndërmarrjes** - nënkupton prezantimin me gojë ose me shkrim të ofruar vullnetarisht nga ndërmarrja pjesëmarrëse në kartel për Autoritetin, duke përshkruar njohuritë dhe rolin e saj në kuadër të kartelit, prezantim ky i cili është hartuar posaçërisht për t'iu dorëzuar Autoritetit, me synim për të përfituar nga lirimi ose zvogëlimi i gjobës.

2. Shprehjet tjera në këtë Udhëzim, korrespondojnë me përkufizimet e përdorura në LMK.

### **Neni 3**

#### **Kriteret e përgjithshme për lirim ose zvogëlim të gjobës**

1. Për t'u kualifikuar për lirimin ose zvogëlim të gjobës për pjesëmarrje në kartel, ndërmarrja duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1.1. Ndërmarrja i ka dhënë fund përfshirjes së saj në kartel, më së voni menjëherë pas kërkesës së saj, me përjashtim për aq sa në mendimin e Autoritetit, do të ishte e nevojshme në mënyrë të arsyetueshme për të ruajtur integritetin e hetimit të tij,

1.2. Ndërmarrja bashkëpunon plotësisht dhe sinqerisht në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpejtësi me Autoritetin që nga momenti i kërkesës së saj, derisa Autoriteti të ketë mbyllur procedurat e tij ndaj të gjitha palëve nën hetim, me marrjen e një vendimi ose të kenë përfunduar ndryshe procedurat e tij, ku një bashkëpunim i tillë përfshin:

1.2.1. Ofrimi i menjëhershëm tek Autoriteti i të gjitha informacioneve dhe provave përkatëse në lidhje me kartelin që është në posedim të ndërmarrjes ose që është i qasshëm për të, në veçanti:

a) Emrin dhe adresën e ndërmarrjes që paraqet kërkesën,

b) Emrat e të gjitha ndërmarrjeve tjera që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në kartel,

c) Një përshkrim të detajuar të kartelit, duke përfshirë produktet, territoret, kohëzgjatjen dhe natyrën e sjelljes së kartelit,

d) Informacion për çdo kërkesë në të shkuarën ose në të ardhmen e mundshme, drejtuar çdo Autoriteti tjetër të konkurrencës në lidhje me kartelin,

1.2.2. Të qëndrojë në dispozicion të Autoritetit për t'iu përgjigjur çdo kërkesë që mund të kontribuojë në vërtetimin e fakteve,

1.2.3. Të vejë në dispozicion të Autoritetit për t'i marrë në pyetje drejtorët, menaxherët dhe anëtarët e tjerë të stafit dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme për të vënë në dispozicion të Autoritetit për t'i marrë në pyetje ish-drejtorët, ish-menaxherët dhe ish-anëtarët e tjerë të stafit,

1.2.4. Të mos shkatërrojë, falsifikojë ose fshehtë informacionin ose provat përkatëse dhe

1.2.5. Të mos zbulojë fakte ose ndonjë përmbajtje, të kërkesës së saj para se Autoriteti të ketë lëshuar njoftimin për konstatimin e fakteve sipas nenit 46 të LMK në procedurat para tij, përveç nëse është rënë dakord ndryshe.

1.3. Gjatë shqyrtimit për t'i bërë një kërkesë Autoritetit, ndërmarrja nuk duhet:

1.3.1. Të ketë shkatërruar, falsifikuar ose fshehur dëshmitë e kartelit ose

1.3.2. Të ketë zbuluar fakte apo ndonjë përmbajtje të kërkesës së planifikuar, përveçse pranë ndonjë Autoriteti të konkurrencës të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejshëm - BE) ose Autoriteteve të konkurrencës të shteteve të tjera.

2. Shoqatat e ndërmarrjeve që kryejnë veprimtari ekonomike për llogari të saj, mund të kualifikohen për përjashtim nga gjopa ose ulje të gjobës, në rastet kur marrin pjesë në një kartel për llogari të tyre dhe jo për llogari të anëtarëve të tyre.

#### **Neni 4 Kriteret për përjashtim nga gjopa**

1. Autoriteti mund të miratojë përjashtimin nga gjopa, të ndërmarrjes e cila është pjesëmarrëse në kartel nëse ajo:

1.1. Plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 3 të këtij Udhëzimi,

1.2. Deklaron pjesëmarrjen e saj në kartel përmes deklaratës së ndërmarrjes dhe

1.3. Sipas nenit 62, paragrafi 1 të LMK është e para që ka paraqitur prova të cilat:

1.3.1. Në momentin që Autoriteti merr kërkesën që i mundëson të fillojë procedurën në lidhje me kartelin, me kusht që Autoriteti deri në atë moment të mos kishte prova të mjaftueshme për të nisur një procedurë të tillë, ose

1.3.2. Sipas mendimit të Autoritetit është e mjaftueshme që ndërmarrja të gjejë/paraqesë kartelin, me kusht që Autoriteti të mos ketë ende prova të mjaftueshme për të gjetur një kartel të tillë dhe që asnjë ndërmarrje tjetër të mos e parashtrijë kërkesën sipas pikës 1.3.1, të këtij neni, në lidhje me atë kartel.

2. Iniciatori ose nxitësi i kartelit nuk mund të përjashtohen nga gjoba në bazë të këtij neni.

## **Neni 5**

### **Deklarata e Ndërmarrjes**

1. Deklarata e ndërmarrjes siç përkufizohet në nenin 2, paragrafi 1.7 të këtij Udhëzimi dhe referuar në nenin 4, paragrafi 1.2 të këtij Udhëzimi, do të jenë pjesë integrale e dosjes së Autoritetit.

2. Deklarata e ndërmarrjes, mund të paraqitet nga ndërmarrja përmes personit të autorizuar apo avokatit të saj.

3. Deklarata duhet të përmbajë:

3.1. Përshkrimin e hollësishëm të kartelit, qëllimet, aktivitetet dhe veprimet, mallrat dhe/ose shërbimet e përfshira në kartel, vlerësimin e kryer të pjesës së tregut të pjesëmarrësve në kartel, zonën gjeografike në të cilën ka efekt karteli, kohëzgjatjen e kartelit, datat, vendet, përmbajtjen dhe personat e përfshirë në realizimin e kartelit, si dhe të gjitha të dhënat e nevojshme, lidhur me provat e paraqitura bashkë me kërkesën,

3.2. Emrin dhe adresën e pronarit të ndërmarrjes e cila ka paraqitur kërkesën, si dhe emrat dhe adresat e të gjitha ndërmarrjeve tjera që marrin ose kanë marrë pjesë në kartel,

3.3. Emrat, pozitat, vendndodhjet e zyrave, si dhe kur është e nevojshme, adresat e shtëpive të të gjithë individëve të cilët, sipas njohurive të ndërmarrjes që parashtron kërkesën, janë ose kanë qenë të përfshirë në kartel, duke përfshirë ata individë që kanë qenë të implikuar në emër të ndërmarrjes që paraqet kërkesën,

3.4. Informacionin nëse kërkesa është parashtruar apo do të parashtrohet pranë ndonjërit prej Autoriteteve të shteteve anëtare të BE-së apo Autoriteteve të shteteve tjera, respektivisht nëse në ndonjë mënyrë u është drejtuar ose ka ndërmend të ju drejtohet këtyre organeve në lidhje me kartelin e raportuar.

## **Neni 6**

### **Regjistrimi i deklaratës gojore të ndërmarrjes**

1. Në rast se deklarata e ndërmarrjes jepet gojarisht, Autoriteti është i detyruar të bëjë audio inçizimin e deklaratës gojore dhe më pas të hartoj një kopje me shkrim të deklaratës gojore e cila do t'i bashkëngjitet lëndës.

2. Përfaqësuesi i autorizuar i ndërmarrjes që jep deklaratën gojore, duhet të nënshkruajë kopjen e hartuar me shkrim të deklaratës gojore.

## **Neni 7**

### **E drejta e qasjes në deklaratën e ndërmarrjes**

1. Autoriteti do të lejojë qasje në deklaratën e ndërmarrjes vetëm për palët në procedurë, pas dorëzimit të njoftimit për konstatim të fakteve sipas nenit 45 të LMK.
2. Qasja në deklaratën e ndërmarrjes sipas paragrafit 1 të këtij neni do të lejohet vetëm me kusht që palët në procedurë ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të zotohen për të mos bërë asnjë kopje me mjete mekanike ose elektronike të asnjë informacioni në deklaratën e ndërmarrjes për të cilën po jepet qasja. Informacioni nga deklarata e ndërmarrjes në të cilën palëve u është dhënë qasje, mund të përdoret vetëm kur është e nevojshme për të ushtruar të drejtat e tyre të mbrojtjes gjatë procedurës së hetimit të kartelit nga Autoriteti ose në procedurat gjyqësore të nisura kundër vendimit të Autoritetit në lidhje me kartelin në fjalë.
3. Nëse palët në procedurë ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, nuk respektojnë detyrimet për përdorim të kufizuar të përmbajtjes së deklaratës së ndërmarrjes, siq përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, Autoriteti varësisht nga rrethanat konkrete të rastit, mund të vlerësojë veprimin e tillë si refuzim për bashkëpunim me Autoritetin ose pengim të procedurës, siq është përcaktuar në nenin 61, paragrafi 5, nën paragrafi 5.2 të LMK.
4. Nëse parashtruesi i kërkesës ose përfaqësuesit e tij të autorizuar, zbulojnë përmbajtjen e deklaratës së ndërmarrjes për ndonjë palë të tretë, detyrimi i palëve në procedurë mbi kufizimin e përdorimit të përmbajtjes së deklaratës së ndërmarrjes, në të cilën është kryer qasja sipas paragrafit 2 të këtij neni, do të pushojë.

## **Neni 8**

### **Kërkesa për përjashtim nga pagesa e gjobës**

1. Ndërmarrja që dëshiron të përfitojë nga përjashtimi i gjobës, duhet të parashtrojë kërkesën sipas kushteve të neneve 3, 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi, ose mund të aplikojë fillimisht për një shënues, i cili në rast të miratimit nga Autoriteti dhe për periudhën kohore të specifikuar nga Autoriteti, i siguron ndërmarrjes vendin në radhën për përjashtim nga gjoba.
2. Autoriteti do të refuzojë kërkesat ose aplikimet për shënues, në qoftë se ato janë parashtruar pasi që Autoriteti ka nxjerrë njoftimin për konstatimin e fakteve sipas nenit 46 të LMK.

## **Neni 9**

### **Kushtet për marrjen e një shënuesi**

1. Ndërmarrja që aplikon për shënues, duhet të japë arsyet që shpjegojnë se përse në momentin e aplikimit nuk mundet të paraqesë kërkesë sipas kushteve të neneve 3, 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi.
2. Në aplikimin për një shënues, ndërmarrja duhet t'i sigurojë Autoritetit informacionet e mëposhtme, në rastet kur janë të disponueshme:

- 2.1. Emrin dhe adresën e parashtruesit të kërkesës,
  - 2.2. Emrat e të gjitha ndërmarrjeve të tjera që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në kartel,
  - 2.3. Produktet dhe territoret e prekura,
  - 2.4. Kohëzgjatjen e kartelit,
  - 2.5. Natyrën e udhëheqjes së kartelit dhe
  - 2.6. Informacion për çdo kërkesë në të kaluarën ose të mundshme në të ardhmen, drejtuar ndonjë Autoriteti të Konkurrencës të Shteteve Anëtare të BE-së ose Autoriteteve të Konkurrencës të shteteve të tjera në lidhje me kartelin.
3. Nëse ndërmarrja parashtron një aplikim për shënues që nuk përputhet me kërkesat e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Autoriteti do të japë një afat shtesë prej jo më pak se 3 (tri) ditë pune për të paraqitur një aplikim të rishikuar për shënues. Nëse ndërmarrja nuk paraqet një aplikim të rishikuar për shënues, ndërmarrja do të humbasë vendin e saj në radhë për përjashtim nga gjoba.
  4. Nëse Autoriteti miraton një shënues për ndërmarrjen, ajo përcakton periudhën kohore brenda së cilës ndërmarrja duhet të paraqesë kërkesën sipas kushteve të neneve 3, 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi.
  5. Nëse ndërmarrja të cilës i është miratuar shënuesi, paraqet kërkesën sipas kushteve të neneve 3, 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi, brenda një afati kohor të caktuar nga Autoriteti, konsiderohet se kërkesa për përjashtim nga gjoba është paraqitur në datën e miratimit të shënuesit.
  6. Nëse ndërmarrja nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni, Autoriteti do ta informojë me shkrim ndërmarrjen që ajo nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtim nga gjoba siq kërkohet me këtë Udhëzim. Ndërmarrja mund të tërheqë provat e paraqitura pranë Autoritetit ose t'i kërkojë Autoritetit t'i konsiderojë ato si një kërkesë për ulje të gjobës sipas këtij Udhëzimi.

## **Neni 10**

### **Konfirmimi për pranimin e kërkesës**

Autoriteti duhet të japë një konfirmim për pranimin e kërkesës së ndërmarrjes për përjashtim nga gjoba, e cila i ka përmbushë kërkesat e këtij Udhëzimi, duke konfirmuar datën dhe kohën e marrjes së kërkesës.

**Neni 11**  
**Renditja e vlerësimit të kërkesave**

Autoriteti nuk do të shqyrtojë kërkesat e tjera për përjashtim nga gjoba në lidhje me të njëjtin kartel, para se të ketë marrë një qëndrim për aplikimin e parë të pranuar nga Autoriteti, pavarësisht nëse aplikimi i parë është kërkesë formale për përjashtim nga gjoba ose aplikim për një shënues.

**Neni 12**  
**Përjashtimi me kusht nga gjoba**

1. Kur Autoriteti merr një kërkesë për përjashtim nga gjoba, ai duhet të vlerësojë nëse kërkesa plotëson kushtet nga nenet 3, 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi.
2. Nëse Autoriteti konstaton se kërkesa për lirim nga gjoba i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, do t'ia miratojë ndërmarrjes përjashtimin me kusht nga gjoba dhe për këtë do ta njoftojë ndërmarrjen me shkrim.

**Neni 13**  
**Refuzimi për të miratuar përjashtimin nga gjoba**

1. Nëse Autoriteti konstaton se kërkesa për përjashtim nga gjoba nuk i plotëson kushtet e neneve 3, 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi do ta njoftojë ndërmarrjen me shkrim.
2. Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, ndërmarrja mund të tërheqë provat e paraqitura pranë Autoritetit ose t'i kërkojë Autoritetit t'i konsiderojë ato si kërkesë për ulje të gjobës sipas këtij Udhëzimi.
3. Provat e tërhequra sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk mund të përdoren nga Autoriteti, megjithatë Autoriteti nuk pengohet të përdorë kompetencat e tij hetimore të parashikuara në LMK për të mbledhur informacione dhe të dhëna përkatëse në kuadër të procedurës së hetimit të të njëjtit kartel ose gjatë procedurave tjera të parashikuara në LMK.

**Neni 14**  
**Përjashtimi nga gjobat**

1. Nëse ndërmarrja e cila ka siguruar përjashtimin me kusht nga gjobat sipas nenit 12 të këtij Udhëzimi, si dhe plotëson kushtet e neneve 3, 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi gjatë gjithë procedurës në Autoritet, atëherë Autoriteti do t'ia miratojë ndërmarrjes përjashtimin nga gjoba me anë të vendimit të nxjerrë sipas nenit 55, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të LMK.
2. Nëse ndërmarrja e cila ka marrë përjashtimin me kusht nga gjoba sipas nenit 12 të këtij Udhëzimi, në çfarëdo momenti gjatë procedurës në Autoritet, shkelë ndonjë nga kushtet e neneve

3, 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi, Autoriteti do të revokojë përjashtimin me kusht nga gjoba dhe menjëherë do të informojnë me shkrim ndërmarrjen për një gjë të tillë.

3. Në rast se ndërmarrjes i është revokuar përjashtimi me kusht nga gjoba sipas paragrafit 2 të këtij neni, ndërmarrjes nuk mund t'i lejohet ulje e gjobës sipas këtij Udhëzimi.

### **Neni 15**

#### **Kushtet e përgjithshme për uljen e gjobave**

1. Autoriteti do të lejojë uljen e gjobës ndaj ndërmarrjes pjesëmarrëse në kartel, sipas kushteve të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Ndërmarrja që paraqet kërkesë për uljen e gjobave pranë Autoritetit duhet:

2.1. Të përmbushë kushtet e nenit 3 të këtij Udhëzimi,

2.2. Të zbulojë pjesëmarrjen e tij në një kartel në deklaratën e ndërmarrjes,

2.3. Të paraqesë prova për kartelin, të cilat përfaqësojnë vlerë të shtuar të konsiderueshme për qëllimin e vërtetimit të kartelit, në raport me provat tashmë në zotërim të Autoritetit në momentin e paraqitjes së kërkesës,

2.4. Dispozitat e neneve 5, 6 dhe 7 të këtij Udhëzimi, do të zbatohen për deklaratën e ndërmarrjes të përmendur në nën paragrafin 2.1 të këtij neni.

3. Çdo ndërmarrje – pjesëmarrëse e kartelit, duke përfshirë iniciatorët dhe nxitësit e kartelit, ka të drejtë të paraqes kërkesë për uljen e gjobave sipas këtij neni. Autoriteti do të përcaktojë uljen individuale të gjobave të ndërmarrjes së caktuar – pjesëmarrëse në kartel, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3, 4 dhe 5 të nenit 17 të këtij Udhëzimi.

4. Autoriteti do t'i refuzojë kërkesat nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse ato janë paraqitur pasi Autoriteti të ketë nxjerrë njoftimin për konstatimin e fakteve sipas nenit 46 të LMK.

### **Neni 16**

#### **Konfirmimi për pranimin e kërkesës dhe renditja e vlerësimit të kërkesave**

1. Autoriteti duhet të sigurojë një konfirmim për marrjen e kërkesës së ndërmarrjes, të paraqitur sipas nenit 15 të këtij Udhëzimi, duke konfirmuar datën dhe sipas rastit edhe kohën e marrjes së kërkesës..

2. Autoriteti nuk do të shqyrtojë kërkesat e tjera për uljen e gjobave, përpara se të ketë marrë qëndrim për aplikimin e parë të pranuar nga Autoriteti, në lidhje me të njëjtin kartel.



## **Neni 17**

### **Kriteret për ulje të veçantë të gjobave**

1. Koncepti i “vlerës së shtuar” i specifikuar në nenin 15, paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 të këtij Udhëzimi, i referohet masës në të cilën provat e ofruara nga ndërmarrja forcojnë, për nga natyra dhe/ose niveli i saj i hollësishëm, mundësinë e Autoritetit për të dëshmuar kartelin.
2. Autoriteti është i detyruar të vlerësojë çdo dëshmi të dhënë në bazë të një kërkesë. Dëshmia me shkrim ose korrespondenca elektronike që buron nga periudha kohore të cilës i përkasin faktet dhe kanë vlerë më të madhe se provat e vërtetuara më pas. Provat inkriminuese që lidhen drejtpërdrejt me faktet për kartel, në përgjithësi do të konsiderohen se kanë një vlerë më të madhe se sa ato me rëndësi vetëm të tërthortë. Në mënyrë të ngjashme, shkalla e vërtetimit që kërkohet nga provat e paraqitura nga burime tjera të jenë të besueshme, ndërmarrjet tjera të përfshira në kartel do të kenë një ndikim në vlerën e asaj prove, kështu që provave bindëse do t'i atribuohet një vlerë më e madhe, se sa p.sh. deklaratës e cila kërkon vërtetim nëse kontestohet.
3. Për ndërmarrjen e parë që jep dëshmi me vlerë të shtuar të konsiderueshme, Autoriteti do të ulë gjobën që përndryshe do të ishte vendosur, me 30% deri në 50%.
4. Për ndërmarrjen e dytë që jep dëshmi me vlerë të shtuar të konsiderueshme, Autoriteti do të ulë gjobën që përndryshe do të ishte vendosur, me 20% deri në 30%.
5. Për çdo ndërmarrje të radhës, që jep dëshmi me vlerë të shtuar të konsiderueshme, Autoriteti do të ulë gjobën që përndryshe do të ishte vendosur, deri në 20%.
6. Nëse ndërmarrja paraqet prova bindëse të cilat Autoriteti i përdor për të vërtetuar fakte shtesë, që çojnë në një rritje të gjobave në krahasim me gjobat që do t'u ishin vendosur pjesëmarrësve të kartelit, Autoriteti nuk do t'i marrë këto fakte shtesë për llogari, me rastin e caktimit të ndonjë gjobe që do t'i shqiptohet ndërmarrjes, e cila ka ofruar këto dëshmi për uljen e gjobave.

## **Neni 18**

### **Ulja e kushtëzuar e gjobave**

1. Nëse Autoriteti vlerëson se kërkesa për uljen e gjobave i plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 15, 16 dhe 17 të këtij Udhëzimi, do t'i autorizojë ndërmarrjes uljen e kushtëzuar të gjobave dhe do ta njoftojë menjëherë ndërmarrjen me shkrim.
2. Nëse Autoriteti vlerëson se kërkesa për uljen e gjobave nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 15, 16 dhe 17 të këtij Udhëzimi, do ta njoftojë ndërmarrjen menjëherë me shkrim.
3. Në rastin e referuar në paragrafin 2 të këtij neni, ndërmarrja mund të tërheqë provat e paraqitura pranë Autoritetit sipas nenit 15 të këtij Udhëzimi.
4. Provat e tërhequra sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk mund të përdoren nga Autoriteti, megjithatë Autoriteti nuk pengohet të përdorë kompetencat e tij hetimore të parashikuara në LMK

për të mbledhur informacione dhe të dhënat përkatëse në kuadër të procedurës së hetimit të të njëjtit kartel ose gjatë procedurave të tjera të parashikuara në LMK.

### **Neni 19**

#### **Vendimi për uljen e gjobës**

1. Nëse ndërmarrja e cila ka siguruar uljen e kushtëzuar të gjobës sipas nenit 18 të këtij Udhëzimi si dhe i plotëson kushtet e nenit 15 të këtij Udhëzimi gjatë gjithë procedurës në Autoritet, atëherë Autoriteti do t'i autorizojë ndërmarrjes uljen e gjobës në vendimin e miratuar sipas nenit 55, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të LMK. Masa specifike e uljes së gjobës do të përcaktohet duke pasur parasysh kushtet e përcaktuara në nenin 17 të këtij Udhëzimi.

2. Nëse ndërmarrja e cila ka siguruar uljen e kushtëzuar të gjobës sipas nenit 18 të këtij Udhëzimi dhe në cilën do kohë gjatë procedurës në Autoritet, shkelë ndonjë nga kushtet e nenit 15 të këtij Udhëzimi, Autoriteti do ta revokojë uljen e kushtëzuar të gjobës dhe do ta njoftojë me shkrim menjëherë ndërmarrjen në lidhje me këtë.

### **Neni 20**

#### **Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ**

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij Udhëzimi Administrativ mund të propozohet nga çdo anëtar i Komisionit dhe bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

### **Neni 21**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Kryetarja**

Neime Binaku - Isufi

---